



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. ___ /2026

Dt. 21 / 05 /2026

Procesverbal

Procesverbal nga Mbledhja e II-të e KKSB-së për vitin 2026

Në mbledhjen e II-të të KKSB-së për vitin 2026 u diskutua gjendja e sigurisë në komunën e Deçanit dhe çështje të tjera me interes për komunitetin.

- Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj, hapi mbledhjen dhe theksoi se situata e sigurisë në komunë vazhdon të jetë e qetë dhe stabile. Ai vlerësoi bashkëpunimin ndërinstitucional dhe kërkoi vazhdimin e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve për ruajtjen e rendit dhe sigurisë.

Komandanti i Policisë në Deçan, z. Xhemë Muriqi, raportoi se gjendja e sigurisë mbetet stabile, megjithëse gjatë periudhës raportuese janë evidentuar disa aksidente trafiku, përfshirë raste me pasoja fatale. Ai theksoi angazhimin e vazhdueshëm të Policisë së Kosovës në ofrimin e sigurisë për qytetarët.

Drejtori për Shërbime Publike, z. Izet Zenuni, ngriti shqetësimin për mungesën e pajisjeve dhe mbështetjes logjistike për njësinë e zjarrfikësve, duke kërkuar investime dhe përkrahje më të madhe nga institucionet përgjegjëse, veçanërisht gjatë sezonës verore.

Kryetari i Bashkësisë Islame në Deçan, z. Naser Tolaj, propozoi organizimin e një tryeze të përbashkët me institucionet relevante për vetëdijësimin e të rinjve lidhur me mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e dukurive negative dhe luftimin e përdorimit të substancave narkotike.

Mbledhja përfundoi me konstatimin se gjendja e sigurisë në komunë është e qetë dhe stabile, ndërsa u theksua nevoja për vazhdimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe adresimin e sfidave të evidentuara.

